


KUJTESË PËR FACT-CHECKING

ËSHTE VËNË RE PËRMBAJTJE E DYSHIMTË



1) Analiza merr kohë. Ndërsa dezinformimi mund të fabrikohet lehtë, kjo nuk do të thotë që zgjidhja do të jetë e lehtë. Sic thotë ligji i Brandolinit: “Sasia e energjisë që duhet për të hedhur poshtë marrëzitë ka një magnitudë më të madhe se ajo për ta prodhuar.”

2) Analiza nuk ka pse të jetë e mërzitshme. Fact-checking tekefundit bazohet në fakte. Megjithatë, analiza e fakteve nuk është e thenë te jetë e thatë dhe sterile, por as nuk duhet të përdorni sensacionalizmin për të qenë interesant. Procesi i fact-checking është shpesh si puna e një detekтиви, dhe mund të jetë ide e mirë të tregoni këtë proces hetues në punën tuaj, gjithmonë duke u siguruar që narrativa të jetë me shije dhe arsye.

3) Jo gjithçka vlen të analizohet. Procesi i zbulimit të së vërtetës mund të jetë i vështirë dhe merr kohë, por kjo nuk do të thotë të bini në pedantizëm. Nëse një media, p.sh., raportoi gabim numrin e tretë pas presjes dhjetore në një shifër ose bën gabim drejtshkrimor në mbiemrin e një personi pa qëllimin që të shtrembërojë ose të falsifikojë historinë, kjo nuk ia vlen të analizohet.

4) Kërkoni mangësitë edhe në analizën tuaj. Ruhuni nga vetëkënaqësia në punën tuaj, sado e mirë dhe e rëndësishme të jetë ajo. Kur mbaroni një pjesë analitike, distancohuni dhe shiheni me këndvështrimin e një lexuesi kritik, duke pyetur veten çfarë kundërshtimesh ose pyetjesh mund të ketë. Gjithashtu, është e këshillueshme që analiza juaj t’i nënshtrohet vëzhgimit kritik të një kolegu para publikimit.

5) Tregoni ecurinë e mbërritjes në pikën përfundimtare. Analiza e fact-checking duhet të jetë edhe e natyrës edukative për lexuesin. Prandaj, është mirë të ndani informacionin e përdorur dhe hapat e verifikimit që keni marrë. Në rast përdorimi të mjeteve apo teknikave specifike, përmendja e tyre në tekstin final do të rrisë vlerat dhe dobinë e tij.

Ky është materiali që mund të përdoret në analizën tuaj. Arkivoni gjithë materialet e mbledhura duke përdorur një shërbim si archive.org.

Mjete verifikimi:

Tekst: Google.com, translate.google.com, scholar.google.com, quetext.com, diffchecker.com, academia.edu, scribd.com. **Imazhe:** google.com, yandex.com, tineye.com, 29a.ch/photo-forensics